



Planuar / Propozuar Punëdhënësi / Propozitor Received / Delivered	04.02.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	No Prot In Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTEK	475/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.436/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.436/2020 të datës 28.12.2020 të parashtruar nga ankuesi, me adresë Rruga: “Xheladin Hana”, në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “transferim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.436/2020 e datës 28.12.2020 e parashtruar nga ankuesi**
- II. MBETET në fuqi Vendimi Nr.Ref.998/2020, i datës 10.12.2020, i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.**

A r s y e t i m

Ankuesi, me datë 24.12.2020 përmes emailit zyrtar ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është regjistruar me datë 28.12.2020 me numër protokoli 3310/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 29.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Më datë 01.02.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3310/2020 të datës 28.12.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.Ref.691/2018, i datës 24.07.2018; Vendimin Nr.Ref.403/2019, i datës 08.08.2019; Nota verbale Ref.nr.124/2020, e datës 04.12.2020; Vendimin Nr.Ref.998/2020, i datës 10.12.2020; Vendimin Nr.Ref.045/2015, i datës 30.12.2015; Vendimin Nr.Ref.116/10, i datës 15 prill

2010; Kërkesa për përgjigje e datës 29.12.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 01.02.2021; Akt emërimi i ankuesit Nr.140, i datës 06.08.2014 dhe Emali zyrtar i datës 01.02.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, *sepse:*

Ankuesi me datë 28.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër Nr.998/2020 të datës 10.12.2020, të Ministres së MPJD-së me të cilin ka vendosur për tërheqjen/kthimin e tij nga misioni në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bullgari, Sofje, në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, sepse nuk është marre për bazë vendimi me numër Nr.403/2019 i datës 08.08.2019 i nxjerr nga Zv. Kryeministri i Parë dhe Ministri i Punëve të Jashtme, me të cilin është përcaktuar se mandati i ri 4 vjeçar fillon nga data 15.04.201.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe punëdhënësi, ka konstatuar se ankuesi ka qene i punësuar në Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas Akt emërimit me numër Nr.140 të datës 06.08.2014 në pozitën “Zyrtar i Lartë për Parlamentin Evropian” në Departamentin për Evropë dhe BE, ndërsa me vendim me numër Nr.Ref.045/2015 të datës 30.12.2015 të Zv. Kryeministrit të Parë dhe Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, është caktuar që të shërbej në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Malmo/Suedi në gradën diplomatike „Sekretar i Parë“. Me datë 24.07.2018 Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, me rekomandim te komisionit për grada dhe discipline ka nxjerre vendim me numër 691/2018 me të cilin i ka dhënë gradën diplomatikë „Këshilltar“. Ankuesi në bazë të vendimit Nr.Ref.403/2019, të datës 08.08.2019 të Zv. Kryeministrit të Parë dhe Ministri të Punëve të Jashtme, në kuadër të lëvizjes paralele, transferohet nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Stokholm/Suedi me gradën e njëjtë “Këshilltar”, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Sofje/Bullgari, me mandat 4 vjeçar, duk filluar nga data 15.09.2019.Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 10.12.2020, nxjerr vendim me numër Nr.Ref.998/2020, me të cilin ankuesin me gradën “Këshilltar”, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Sofje/Bullgari, për nevoja të punës në Ministri, e tërheq/kthen nga misioni në Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, e ka shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Nr.Ref.998/2020 të datës 10.12.2020 me të cilin ankuesin me gradën „Këshilltar“, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Sofje/Bullgari, për nevoja të punës në Ministri e tërheq/kthen nga misioni në Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht me nenin nenin 22 dhe 23 (pika 1.1) të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, si dhe nenin 10 paragrafin 9 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **“Përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhe katër (4) vjeçare, ose ndryshe sipë kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrit të Punëve të Jashtme”**, konstatoi se është e drejtë ekskluzive e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që me qëllim të përmbushjes së nevojave të punës në Ministri tw ndryshoje qëndrimin ne mision përpara mbarimit të afatit të caktuar, respektivisht Ministri ka te drejtë që të marr vendim, lidhur me ndryshimin e kohës së shërbimit jashtë vendit të nëpunësve të ministrisë. Neni 22 i Ligji Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, ndërlidhur me nenin 23 paragrafin1 nën paragrafin 1.1 dhe 2 të Ligji Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës përcakton

se: "Tërheqja e parakohshme nga misioni diplomatik. 1.1. për nevoja pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme", dhe „ Tërheqja e të gjithë përfaqësuesve të tjerë

diplomatikë, duke mos e përfshirë shefin e misionit, për të njëjtat arsye të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet me urdhërin e Ministrit të Punëve të Jashtme" rrjedhimisht nga kjo Kolegji konstaton se Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme ka kompetencë që të tërheq/kthej të gjithë përfaqësuesit të tjerë diplomatikë përveç shefit të misionit nga shërbimi i jashtëm për shërbim gjegjësisht nevoja pune në Ministri edhe gjatë kohës sa nëpunësi i jashtëm i ministrisë apo përfaqësuesi diplomatikë ka mandat, andaj Kolegji konstaton se Vendimi me numër Nr.Ref.998/2020, i datës 10.12.2020 i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është nxjerr edhe në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e nenit 10 konkretisht paragrafin 8 dhe 9 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ku përcaktohet se: **"8.Kohzgjatja në detyrë për zyrtarët e angazhuar në shërbim jashtë vendit mund të ndryshojë sipas nevojave të shërbimit ... dhe 9.Ministria ka autoritet të ndryshojë standardet e kohëzgjatjes së shërbimit varësisht nga kushtet e vendit të misionit ose nevojat e shërbimit.**

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.436/2020

Hysni Mustafa

Hysni Mustafa
Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Malsore Gashi Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.